



Udhëzime për aplikuesit që i përgjigjen thirrjes për propozime për vitin 2016

1. Historiku/përmbledhje

Projekti **“Reagimi i Shpejtë për Stabilizimin e Komunitetit,”** i financuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve (ZÇK) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ofron një mjet kompleks në adresimin e nevojave aktuale socio-ekonomike për komunitetet jo-shumicë, gjegjësisht komunitetet Serb, Turq, Boshnjak, Romë, Ashkali, Egjiptian dhe Goran.

Në këtë aktivitet/masë, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) do të ofrojë grante dhe mbështetje këshillimore për gjenerimin e të ardhurave familjare. Qëllimi i projektit është përkrahja e familjeve lokale në gjenerimin e të ardhurave shtesë dhe të qëndrueshme dhe për përmirësimin e ekonomisë vendore. Përkrahja do të rris në maksimum potencialin për zhvillim, duke kontribuar në përmirësimin e gjendjes socio-ekonomike të këtyre komuniteteve.

Bazuar në nevojat specifike të komunave, komunitetin dhe profilin e biznesit do të përkrahen personat që jetojnë në komunat e **Graçanicës, Novobërdës, Gjilanit, Vushtrrisë, Klinës dhe Obiliqit.** Kjo skemë përpiqet të mbulojë fusha që kanë mungesë të masave të mjaftueshme për përmirësimin e jetesës të komuniteteve lokale jo-shumicë, por gjithashtu edhe ku komunitetet lokale janë kryesisht të angazhuara në prodhimin bujqësor, siç është edhe fokusi i kësaj skeme.

2. Për çka?

Aplikuesit e përzgjedhur do të përkrahen në:

2.1 . Prodhimtarinë bujqësor:

- a) kultivimin e perimeve dhe frutave, përmirësimin e teknikave të kultivimit, bletari, etj.
- b) zhvillimin e aktiviteteve blegtorale në shkallë të vogël.

2.2 . Përpunimi dhe paketimi i ushqimit

Përpunimi i frutave dhe perimeve (prodhimi i mjaltit, reçeleve, ajvarit, turshive, lëngjeve, etj.), përpunimi i bimëve mjekësore (farmaci tradicionale), përpunimi i qumështit në shkallë të vogël apo prodhimi i bulmetit (gjalpë, ajkë, jogurt, djathë), etj.

3. Çfarë mund të përfitoni?



Empowered lives.
Resilient nations.

UNDP do të ofrojë ndihmë financiare në **vlerë maksimale prej 4400 EUR** në materiale, makineri, vegla, bagëti dhe pajisje me qëllim përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve të tyre aktuale në prodhimtari. Grantet nuk mbulojnë kostot administrative ose pagat.

Përfituesit e përzgjedhur duhet të marrin pjesë në një trajnim (1-2 ditë) për shkathtësitë bazë në ndërmarrësi (aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave, vlerësimin e tregut, kornizën ligjore, etj.) në mënyrë që të aftësohen në aktivitetet e tyre të gjenerimit të të ardhurave, por edhe në zhvillimin e tyre.

4. Kush mund të aplikojë?

Të gjithë aplikuesit duhet:

- të kenë ide se si të zgjerojnë aktivitetet e tyre ekzistuese në fushat e:
 - 1) sektorit të bujqësisë, me qëllim të rritjes dhe përmirësimin të prodhimtarisë;
 - 2) industrisë për përpunimin dhe paketimin e ushqimit
- Të jenë në moshën e punës
- Të jenë nga komunitetet jo-shumicë, Serb, Turq, Boshnjak, Rom, Ashkali, Egjiptian dhe Goran e që jetojnë (banojnë) në komunat e **Graqanicës, Novobërdës, Gjilanit, Vushtrrisë, Klinës dhe Obiliqit.**

a. Aplikuesit

Aplikuesi duhet:

- Të jetë anëtar i familjes me më shumë se 5 anëtarë,
- Të jenë pronarë i ndonjë ferme të vogël (më pak se 2ha) – **vetëm në rast të aplikimit për prodhimtarisë bujqësore (2.1);**
- Së paku gjysma e anëtarëve ekonomikisht aktiv të familjes duhet të jenë të regjistruar si të papunë/punëkërkues në zyrat komunale të punësimit.
- Të ketë në pronësi apo me qira ndonjë hapësirë për prodhimtari/kultivim
- Të ketë shkathtësi dhe përvojë të përfundojë me sukses aktivitetet e propozuara
- Lejohet vetëm një aplikacion për familje

b. Aplikuesit nuk mund:

- Të kenë biznes të regjistruar ku gjenerohen të ardhura e që ka më shumë se 2 punonjës të regjistruar,
- Asnjëri nga aplikuesit nuk mund të jetë në marrëdhënie pune apo familjare me stafin e UNDP, ZÇK apo komunës.
- Aplikuesit nuk mund të aplikojnë më shumë se njëherë.

5. Aktivitetet që do përkrahen

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve që janë relevante për sektorët e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit mund të financohen por nuk kufizohen në:



- Futjen e teknikave dhe praktikave moderne të blegtorisë dhe kultivimin e kulturave, përfshirë eksperimentimin me kultivimin dhe hibridet e reja të kulturave;
- Përmirësimin e infrastrukturës së prodhimit bujqësor me qëllim të rritjes dhe përmirësimit të prodhimit dhe cilësisë së produkteve bujqësore (serrave, pajisjeve, etj.);
- Zgjerimin e fermës ekzistuese, rritjen e numrit të kopeve, fillimin apo rritjen e një pemishte
- Përmirësimin apo fillimin e bizneseve të industrive të prodhimit dhe paketimit të ushqimit (përkrahje me paketim, ftohje, pajisjet për ruajtje, përpunim),
- Përmirësimin apo fillimin e bizneseve të aktiviteteve të prodhimit të frutave dhe perimeve p.sh. (prodhimi i mjaltit, reçelevë, salcë (ajvar), lëngjeve, etj.),
- Përmirësimin apo fillimin e bizneseve të aktiviteteve të përpunimit të qumështit
- Fermat e reja të vogla të mishit (d.m.th. viçave, shpezëve dhe peshkut)
- Blerja e materialeve për renovimin apo rregullimin e lokaleve për aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave;

Grantet NUK mund të përdoren për:

- Prodhimin e pijeve me përmbajtje alkoolike dhe pijeve alkoolike (mbi 18% alkool)
- Blerjen e automjeteve transportuese
- Blerjen e pasurive të patundshme (tokës, ndërtesave, etj.)
- Prodhimin e produkteve të duhanit
- Reklamim
- Aktivitete tjera që nuk janë në harmoni me synimet dhe objektivat e thirrjes për propozim dhe projekt

6. Vlerësimi

Paneli vlerësues përzgjedhës do të përbëhet nga tre anëtarë në maksimum. Procesi i përzgjedhjes do të përbëhet nga dy runde:

6.1. Procesi para përzgjedhjes – Pas vlerësimit të cilësisë së projekteve dhe aspekteve formale të aplikacioneve, **25 aplikacione** me pikët më të larta do të (para) përzgjidhen.

6.2. Procesi final i përzgjedhjes – Do të bëhet shqyrtimi i dokumenteve të nevojshme, si dhe do të realizohen vizita në terren tek 25 aplikuesit më të mirë. Lista e aplikacioneve të vlerësuara si më të mirat do të publikohet në ndërtesat përkatëse komunale. Propozimet e përzgjedhura me rezultatin më të lartë do të përfitojnë nga veprimi. Nëse ndonjë përfitues i kualifikuar nuk është në gjendje apo refuzon të marrë pjesë në veprim, atëherë përzgjidhet aplikuesi i ardhshëm me rezultatin më të lartë.

Hapja e thirrjes	22 mars
Afati i fundit për aplikim	10 prill
Procesi para përzgjedhjes	18 prill
Procesi final i përzgjedhjes – Rezultatet	1 maj



Empowered lives.
Resilient nations.

përfundimtare	
Trajnimi	16-20 maj
Zbatimi	1 maj – 30 qershor

Blerja e materialit të aprovuar do të ofrohet nga UNDP në bashkëpunim dhe komunikim me aplikuesit e përzgjedhur.

7. Si të aplikoni

Aplikuesit duhet të dërgojnë një propozim ku përshkruajnë idenë e tyre të veprimtarisë. Aplikuesit mund të aplikojnë në gjuhën Angleze, Shqipe apo Serbe, në formatin që mund të shkarkohet nga ueb-faqja e UNDP (www.undp.org) apo që është në dispozicion në Zyrën përkatëse Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ju lutemi dërgoni aplikacionet jo më vonë se data 10 prill 2016 në orën 17:00:

- **Dërgimi online me dokumentin e bashkangjitur** tek shkelzen.hasani@undp.org
Ju lutemi vendosni në titull (Subjekt): **RRP2 GRANTS,**
Apo
- **Dërgimi personalisht.** Aplikacionet e shtypura dhe të nënshkuara tek Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK).
Apo
- **Dërgimi me postë apo personalisht** i aplikacioneve të shtypura në formatin A4 në një zarf të mbyllur me këto informacione:
 - Zyra e Projektit të UNDP, Rr. Zagrebi 39, Prishtinë
 - (Adresa e aplikuesit)
 - GRANTS RRP2 – MOS E HAP

Çdo aplikacion i pranuar pas kohës dhe datës së specifikuar për pranim do të konsiderohet si me vonesë dhe jo i përgjegjshëm.

8. Kriteret e përzgjedhjes

Aplikacionet e pranuar do të vlerësohen me pikë në bazë të cilësisë dhe arsyeshmërisë të aplikacioneve të tyre, sipas kriterëve në vijim:

- Aryeshmëria e idesë së propozuar të veprimtarisë,
- Përmirësimin të produktivitetit,
- Ndikimi në gjenerimin e të ardhurave familjare apo individuale,
- Ndikimi i projektit në mbrojtjen dhe menaxhimin mjedisor, çfarë ndikime do të ketë projekti në mjedis – a janë vendosur kushte për shmangien e efekteve negative në burimet natyrore mbi të cilat varet veprimi dhe mbi mjedisin më të gjerë natyror.



Empowered lives.
Resilient nations.

Pikë shtesë do të marrin:

- Familjet me fëmijë
- Aplikuesit që banojnë në zona rurale
- Të kthyerit
- Aplikuesit që nuk kanë qenë të punësuar për një kohë të gjatë
- Aplikuesit që nuk kanë përfituar kurrë nga skemat paraprake të granteve (nga komunitet, ministritë apo organizatat ndërkombëtare)
- Për krijimin e një pozite tjetër të punës
- Ndikimit të projektit në integrimin gjinor

9. Informacione të mëtejshme në lidhje me aplikimin

Nëse keni pyetje kontaktoni Zyrën e UNDP, Rr. Zagrebi 39 Tel. Nr: +038 249 066, lokali. 316 apo email; shkelzen.hasani@undp.org.

Apo kontaktoni Zyrtarin për Komunitete dhe Kthim në komunën tuaj përkatëse.

Komuna	Emri	E-mail	Nr. i telefonit
Graçanicë	Elvira Cesasi	2005982@gmail.com	049 - 764 957
Novobërdë	Jasmina Deniq	jasminadenicokpz@gmail.com	044 - 948 202
	Marko Markovic	N/A	N/A
Gjilan	Milivoje Zivkovic	kzp.gnjilane@gmail.com	044 - 917 624
	Elez Kurteshi	elez_kurteshi@hotmail.com	044 - 985 316
Obiliq	Slavisa Adjancic	slavisa.adjancic@rks-gov.net	049 - 831 230
Klinë	Milorad Sarkovic	milorad.sarkovic@rks-gov.net	044 - 418 167
Vushtrri	Branislav Vuksanovic	branislav_v@live.com	045 - 202 976

Mund të adresoni vetëm pyetjet mbi procedurat, jo pyetjet mbi kontekstin e aplikacionit.